



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 693/5 prot.

Tiranë më 27.07.2020

VENDIM

Nr. 31, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN "EATIT" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "EATIT" SHPK (në vijim, "*Kontrolluesi*"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 87, datë 05.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "EATIT" SHPK.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtari tregtare nëpërmjet platformës online [www.baboon.al](http://www.baboon.al), me qëllim ndërmjetësimin midis klientëve (individë) dhe subjekteve tregtare, të tilla si restorante, piceri, fast-food, etj.

Subjektet tregtare publikojnë produktet e tyre në faqen e internetit të Kontrolluesit, [www.baboon.al](http://www.baboon.al). Me qëllim marrjen e shërbimeve të Kontrolluesit dhe të subjekteve që publikojnë produktet e tyre në faqen e internetit të këtij të fundit, klientët mund të

regjistruhen (krijojnë llogari) në faqen e internetit në fjalë, ose të instalojnë në pajisjet e tyre elektronike aplikacionin e Kontrolluesit, të quajtur “*Baboon*”.

Sa më sipër, rezulton se klientët duhet të përdorin të dhëna personale si “*emër, mbiemër, adresa, detaje të adresës, gjinia, data e lindjes, numër telefoni dhe adresë e-mail*”.

Gjithashtu, nëpërmjet aplikacionit të tij, rezulton se Kontrolluesi përpunon dhe të dhënat “*gjeolokalizimi, modeli i telefonit smart, historiku i adresave, historik aksesi/njoftimi*”.

Kontrolluesi përpunon të dhënat personale “*gjinia*” dhe “*data e lindjes*” të subjekteve të të dhënave “*klientë*”, në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, sanksionuar në germën “c”, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim që të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin e përpunimit, duke respektuar parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave personale të sanksionuar në germën “c”, të nenit 5 të Ligjit, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

2. Nga verifikimi i kryer në bazën e të dhënave në faqen e internetit [www.baboon.al](http://www.baboon.al), konstatohet se edhe pasi aplikacioni “*Baboon*” çinstalohet nga pajisja përkatëse elektronike e përdoruesit, të dhënat e përdoruesit vijnë në ruhen.

Në faqen e internetit të Kontrolluesit [www.baboon.al](http://www.baboon.al) nuk rezulton të jetë i disponueshëm ndonjë mënyrë për çregjistrimin apo për informimin e subjekteve të të dhënave lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave në përputhje me parimin e kohës së ruajtjes së të dhënave personale, të sanksionuar në germën “d” të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë përpunuar të dhënat personale. Në momentin kur qëllimi i përpunimit ka përfunduar është e nevojshme që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një palë e tretë në cilësinë e përpunuesit, të realizojë shkatërrimin/fshirjen e të dhënave personale, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

3. Gjatë instalimit të aplikacionit “*Baboon*”, rezulton se përdoruesit i paraqitet në ekranin e pajisjes përkatëse elektronike një rubrikë informuese lidhur me përdorimin e këtij aplikacioni, por, nga ana tjetër, konstatohet se kjo rubrikë nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Në ndërfaqen e regjistrimit të klientëve të rinj, konstatohet të jenë vendosur lidhjet informuese “*Politika e Privatësisë*”, “*Terma dhe kushte*”, si dhe “*Cookies Policy*”, por



konstatohet se pasi klikohet mbi to, asnjëra prej tyre nuk jep informacionin përkatës informues, por të rikthejnë në të njëjtën faqe.

Deklarata e Privatësisë e publikuar në fund të faqes së internetit [www.baboon.al](http://www.baboon.al), si dhe në aplikacionin “*Baboon*”, nuk informon subjektet e të dhënave lidhur me fushën dhe qëllimin e përpunimit, kohën e ruajtjes së të dhënave, faktin nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2012, të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr.6*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i “*Politikave të Privatësisë*” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

3. Kontrolluesi disponon kontrata shërbimi me palë të treta të tilla si restorante, shërbimin e mjekut në punë, ofrimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimit (TIK), etj.

Në dispozitat e kontratave në fjalë nuk parashikohen detyrimet e palëve për përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Pika 1 e nenit 21 të Ligjit parashikon se njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë.



Kontrolluesi, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej datës 21.12.2015.

Më tej, pika 1 e nenit 25 të Ligjit parashikon se kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

5. Kontrolluesi ka hartuar "*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*". Dokumenti i hartuar nga Kontrolluesi nuk parashikon rregulla specifike për të gjitha proceset përpunuese që kryhen (përpunimin e të dhënave personale të klientëve, punëmarrësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj.), në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin Shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr.47, datë 14.09.2018, të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.



SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit "Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" (në vijim, "Udhëzimi nr. 48"), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, kanë pranuar disa nga shkeljet e konstatuara dhe në pretendimet me shkrim kanë deklaruar se do të marrin masa për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

Ndonëse Zyra e Komisionerit e vlerëson këtë qëndrim, kjo nuk e përjashton Kontrolluesin nga përgjegjësia administrative pasi shkeljet e konstatuara, janë kryer para daljes së urdhrin të kontrollit.

Gjithashtu, gjatë procesit të hetimit administrativ, Kontrolluesi, nëpërmjet shkresës nr.643/02 Prot, datë 16.06.2020, i ka paraqitur Zyrës së Komisionerit një kërkesë për interpretim lidhur me faktin, nëse numri i telefonit përbën të dhënë personale. Këtë kërkesë Kontrolluesi e përsëriti edhe gjatë seancës dëgjimore.

Në lidhje me këtë çështje, Zyra e Komisionerit, ripërsërit qëndrimin e saj, të paraqitur gjatë seancës dëgjimore, se numri individual i telefonit përbën një të dhënë personale në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të Ligjit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germave "a", "b", "ç", "d", dhe "dh" të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- c) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;



d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 (pika 1, germa "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
2. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
3. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje detyrimet e përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit të "Politikave të Privatësisë" në faqen e internetit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përditësojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij, si dhe

sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, deponon pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet e përcaktuara sipas këtij akti, brenda afateve si vijon:
  - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 3, 4, dhe 6 më sipër; dhe
  - (ii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 7 më sipër.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
10. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 27.07.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

